



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 2013/ prot.
11

Tiranë, më 01.04. 2025

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1088/1, datë 19.11.2007.

SHOQËRISË “MINERAL INVEST” SH.P.K

Njësia Bashkiake Nr. 9, Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Kati 2, Tiranë

Për dijeni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “MINERAL INVEST” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1088/1, datë 19.11.2007, për mineralin krom, në Objektin “Galeria 29, Zona D, H +1194 deri H +1270”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 1305, datë 04.03.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 2013, Prot., datë 06.03.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1088/1, datë 19.11.2007, për mineralin krom, në Objektin “Galeria 29, Zona D, H +1194 deri H +1270”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2024.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1088/1, datë 19.11.2007, për mineralin krom, në Objektin “Galeria 29, Zona D, H +1194 deri H +1270”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1088/1, datë 19.11.2007, për mineralin krom, në Objektin "Galeria 29, Zona D, H +1194 deri H +1270", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTRI**

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

OTENO KLOSI

